

ANALYSIS OF GOOGLE TRANSLATE'S TRANSLATION AND THE AUTHOR'S FROM ALBANIAN TO SERBIAN LANGUAGE

ANALIZA E PËRKTHIMIT TË GOOGLE TRANSLATE-IT DHE E AUTORIT NGA GJUHA SHQIPE NË SERBISHT

Angjela MARKOVIQ¹, Naile MALA-IMAMI²

^{1*} *Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Belgrade*

² *Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Belgrade*

^{*} *Corresponding author: e-mail: markovic.m.andjela@gmail.com; andjela.markovic@fil.bg.ac.rs*

Abstract

Literary translation, as one of the most complex forms of translation, requires a special approach and attention, given that it involves not only conveying meanings but also preserving the style of the original text. Although the translation of texts using various online tools is becoming increasingly common today, the question arises - are these tools advanced enough, and can they replace the translation done by human authors? As our corpus material, we used specific excerpts from the first chapter of Ismail Kadare's novel 'The Palace of Dreams,' which we translated using Google Translate and compared with the Serbian translation of this novel by Shkëlzen Maliqi.

The aim of the paper is to examine the reliability of machine translation, i.e. analysing the mistakes it makes, compared to the translation of competent and professional translators. The comparison process is based on different linguistic disciplines, and we have come to the conclusions that Google Translate has not yet improved enough to become the main tool in the translation of literary texts, where professional translators still play a key role. Of course, the question arises - whether it would perform better in translating other types of literary texts or in translating different language groups, considering its diverse corpus of literary texts in its memory?

Keywords: literary translation, Google Translate platform translation, author's translation, Albanian, Serbian.

Përmbledhje

Përkthimi letrar është një nga përkthimet më të ndërlikuara dhe kërkon një qasje dhe vëmendje të veçantë, duke pasur parasysh faktin se përveç transmetimit të kuptimit gjithashtu duhet të ruhet stili i tekstit original. Megjithatë, sot është bërë gjithnjë e më i zakonshëm përkthimi i teksteve nëpërmjet veglave të ndryshme në internet, por shtrohet pyetja - a janë këto vegla të avancuara mjaft dhe a mund të zëvendësohet përkthimi i autorit me këtë përkthim? Si korpus përdorëm disa pjesë të kapitullit të parë të romanit "Pallati i ëndrrave" të Ismail Kadaresë, të cilat i përkthyem përmes Google Translate dhe i krahasuam me përkthimin e këtij romani në gjuhën serbe, përkthimin e të cilit e ka bërë autori i përkthimit Shkëlzen Maliqi.

Qëllimi i punimit është të ekzaminojë besueshmërinë e përkthimit me makinë, d.m.th. të analizojë gabimet që krijohen, në krahasim me përkthimin e përkthyesve kompetentë dhe profesionalë. Procesi i krahasimit bazohet në disiplina të ndryshme gjuhësore dhe ne kemi arritur në përfundim se Google Translate nuk është përmirësuar ende sa duhet për t'u bërë mjeti kryesor në përkthimin e teksteve letrare, ku përkthyesit profesionalë ende luajnë rol vendimtar. Natyrisht, shtrohet pyetja - a do të gjendej më mirë Google Translate me përkthimin e ndonjë lloji tjetër të tekstit letrar ose në përkthimin e ndonjë grupi tjetër gjuhësh, duke pasur parasysh përbërjen e ndryshme të teksteve letrare që ka në memorien e vet?

Fjalët kyçe: përkthimi letrar, përkthimi i platformës Google Translate, përkthimi i autorit, shqip, serbisht.

1. Hyrje

Përkthimi letrar është sfidues, pasi kërkon saktësi gjuhësore, një ndjenjë të mprehtë për stil dhe njohuri dhe kuptim të plotë të gjuhës dhe të kulturës, në mënyrë që të përhapet kuptimi dhe atmosfera e saktë e tekstit origjinal. Globalizimi krijoi nevojën për më shumë përkthyes, prandaj përkthimi me makinë dhe përmirësimi i tij është bërë përparësi për shumë gjuhëtarë dhe inxhinierë. Në këtë kuptim, përkthimi me ndihmën e Google Translate-it po bëhet gjithnjë e më i pranishëm në përdorimin e përditshëm. Megjithatë, pavarësisht kësaj, lind pyetja – a duhet të mbështetemi në këtë lloj ndihme te përkthimi letrar, ku interpretimet delikate dhe nuancat stilistike luajnë një rol të madh?

Punimi bazohet në analizën e besueshmërisë së përkthimit me makinë në krahasim me përkthimin e autorit të një veprë letrare nga shqipja në serbisht. Duke përdorur një korpus që përfshin shembujt e fjalive nga kapitulli i parë i romanit *Pallati i ëndrrave* të Ismail Kadaresë, ne vëmë në kundërshtim përkthimin me makinë të marrë përmes Google Translate-it dhe përkthimin e autorit Shkëlzen Maliqi. Duke u nisur nga supozimi se përkthimi me makinë nuk mund ta zëvendësojë mjaftueshëm përkthimin e një përkthyesi kompetent, i analizuar ndryshimet në strukturën gramatikore, zgjedhjen leksikore, stilin e të shkruarit, por edhe përcjelljen e nuancave delikate të kuptimit. Nëpërmjet punimit analizuar mundësitë që ofron përkthimi me makinë në kuadër të përkthimit letrar, duke theksuar rëndësinë e rolit të përkthyesve profesionalë në ruajtjen e origjinalitetit të përkthimit të veprave letrare.

2. Përkthimi me makinë

Në librin e tyre *An introduction to Machine Translation* Hutchins dhe Somers (1992) vërejnë në mënyrë interesante se përkthimi me makinë është "një nga ëndrrat më të vjetra të njerëzimit", por dikush për të qenë përkthyes i vërtetë duhet të jetë një qenie njerëzore e plotë. Përkthimi shpesh shihet si transferim i kuptimit të një teksti nga një gjuhë në tjetrën, por mendohet se duke përdorur një gjuhë tjetër një person e paraqet veten si dikush që nuk është, gjë që e bën këtë proces më të ndërlikuar sesa që duket (Newmark 1988 : 5).

Vetëm përkthimi i tekstit nuk duhet të jetë qëllimi përfundimtar i përkthyesit, sepse procesi i përkthimit përfundon vetëm pas leximit të përkthimit. Lexuesi është pjesëmarrës aktiv në këtë proces, sepse ai e transformon subjektivisht materialin që merr. Ky proces ka tri faza – autori e interpreton realitetin, përkthyesi e interpreton veprën origjinale dhe lexuesi përkthimin (Levy 2011: 30). Përkthimi duhet t'i sigurojë lexuesit njësoj si vepra origjinale, d.m.th., duke lexuar përkthimin, ai duhet ta përjetojë tekstin në të njëjtën mënyrë si lexuesi origjinal, sepse përndryshe lexuesi do të privohet në masë të madhe (Jerотијевић 2012: 168).

Natyrisht, përkthimi fillon me një përkthim të fjalëpërfjalshëm, por kur i vendosim fjalët dhe i vështrojmë në kontekstin e tyre sintaksor, kolokual, kulturor, individual dhe idiolektik, arrijmë te një problem dhe duhet ta kërkojmë zgjidhjen e tij. Edhe pse konteksti luan një rol të rëndësishëm, ai nuk ka gjithmonë epërsi ndaj ndonjë teorie dhe nuk duhet të jetë faktor vendimtar në përcaktimin e qasjes së përkthimit (Newmark 1988: 70–75), përkthyesi duhet t'i njohë edhe rregullat gramatikore, d.m.th., morfologjinë dhe sintaksën e gjuhës (Xhaferi 2023: 10).

Nga cilado fushë që përkthyesi e përkthen tekstin, nga drejtësia dhe letërsia deri te reklamata dhe titrat e filmave, ai përballet me tri dimensione të tekstit: gramatikën, përdorimin e gjuhës (kontekst dhe qëllim) dhe kulturën (Rajić 2008: 51). Përkthimi me makinë është përkthim i krijuar me ndihmën e softuerit të përshtatshëm, me anë të të cilit një tekst i shkruar në gjuhën burimore shndërrohet në një tekst tjetër në gjuhën e synuar (Forcada 2010: 215). Prandaj, është e rëndësishme të kihet parasysh se përkthimi me makinë nuk përfshin një sërë sfidash gjuhësore, kulturore dhe semantike që përkthyesit duhet t'i kapërcejnë për ta përkthyer një vepër saktë, në mënyrë cilësore dhe mbi të gjitha kuptimplotë.

Edhe nëse përkthejnë nga një gjuhë e huaj në gjuhën e vet amtare, përkthyesit duhet të jenë njohës të kulturës dhe të kenë njohuri të mira për gjuhën e tyre për të përcjellë mesazhin e saktë (Murtezi-Ajdini, Saliu, Saliu 2022: 243). Prandaj, për ta bërë përkthimin në nivelin e duhur, përkthyesi duhet t'i njohë të dyja gjuhët, por të zotërojë edhe njohuri të caktuara nga disiplinat e tjera shkencore, si sociolinguistika, psikolinguistika, semantika, antropologjia, etnografia dhe etnologjia etj. (Alili 2020: 39). Përkthimi është një urë lidhëse midis dy kulturave, dy historive, dy pikëpamjeve të botës (Jerotijević 2012: 179). Kështu, përkthimi është i vështirë për kompjutera për arsye të thjeshta se është i vështirë edhe për njerëz (Arnold 2003: 113).

3. Përkthimi përmes programit të Google Translate

Google Translate është program i dobishëm që mund të na ndihmojë shumë, sepse është një mënyrë e shpejtë për ta bërë përkthimin e një teksti apo edhe të një fjale të vetme, por gjithmonë duhet të përpunohet dhe të analizohet në mënyrë që teksti ta marrë kuptimin e plotë. Disa nga avantazhet e këtij mjeti janë përkthimi i shpejtë dhe kuptueshmëria e tekstit, si dhe afërshmëria për të gjithë përdoruesit, por mangësitë janë ende se ai nuk mund të përkthejë shumë fjalë menjëherë, por edhe disa fjalë nuk i përkthen (emrat e përveçëm janë një problem i madh), fjalët shpesh humbasin kuptimin e tyre, etj. (Saliu 2023: 554–555)

Në fushën e përkthimit letrar, përkthimi me makinë ndryshon shumë nga përkthimi i autorit, por kjo nuk do të thotë se ai nuk është i dobishëm në shumë fusha të tjera, të cilat duhet të shënohen dhe të përdoret në to (Forcada 2010: 215). Për ta përmirësuar veçlën e internetit Google Translate, e cila bazohet në idenë se në këtë mënyrë do të bëjë më pak gabime në përkthimin e vet, janë duke u mbledhur sasi të mëdha përkthimesh të autorëve (Hansen 2010: 387).

Nëse e përdorim përkthimin me makinë vetëm për ta përafruar idenë e përmbajtjes së tekstit, d.m.th. thelbin e tij, atëherë gabimet në përkthim nuk kanë shumë rëndësi nëse lexuesi arrin ta përcjellë kuptimin bazë të tekstit, por është e qartë se këto përkthime duhet t'i rishikojnë dhe t'i korrigjojnë përkthyesit profesionalë. Meqenëse njeriu është i nevojshëm që të bëjë një përkthim adekuat, puna e përkthyesit është e një rëndësie thelbësore, dhe procesi i interpretimit depërton thellë në psikologji dhe është e nevojshme të zbulohet edhe ana jogjuhësore në mënyrë që përkthimi ta zgjojë të njëjtën përvojë estetike të të gjithë lexuesit (Jerotijević 2012: 179).

4. Përshkrimi i hulumtimit

Hulumtimi i bërë për qëllimet e këtij punimi i referohet analizës së gabimeve që kanë ndodhur gjatë përdorimit të përkthimit me makinë në shembuj specifikë të fjalive të marra nga kapitulli i parë i romanit *Pallati i ëndrrave*. Romani *Pallati i ëndrrave* i Ismail Kadaresë tregon për sistemin e mbyllur të despotizmit oriental gjatë Turqisë Osmane. Historia zhvillohet në Tabir Saraj, ku mbledhen, klasifikohen dhe interpretohen ëndrrat e qytetarëve dhe veçohen ato që janë të rrezikshme për perandorinë. Personazhi kryesor është Mark-Alem Qyprilliu, i cili vjen nga një familje e vjetër shqiptare, e cila dha disa vezirë, por që kalon çaste të vështira.

Ky roman paraqet vizionin e shkrimtarit për ferrin, të cilin ai e percepton si një shtet totalitar ku gjithçka është nën kontroll, madje edhe ëndrrat e qytetarëve. Meqenëse nuk kishte gabime teknike (shenjat e pikësimit u transferuan plotësisht nga teksti origjinal, si dhe shkronja e madhe), gabimet e vërejtura i ndamë në pesë grupe, përkatësisht: 1) gabime gramatikore; 2) gabime leksikore; 3) gabime stilistike; 4) term i gabuar; 5) përkthim i fjalëpërfjalshëm dhe 6) fjalët të cilat mbeten të papërkthyer. U nisëm nga supozimi se përkthyesit me makinë bëjnë gabime dhe se u nevojiten njohuri të caktuara të gjuhës së referuar për t'i njohur këto gabime, por edhe nga supozimi se përkthimi i një përkthyesi letrar profesional do të jetë më cilësor, duke marrë parasysh se një lloj i tillë i përkthimit kërkon krijimtari të madhe.

Gjithashtu, konsideruam se numri më i madh i gabimeve në përkthimin me makinë do të bëhet për shkak të kuptimeve të shumëfishta të fjalëve, homonimisë dhe sinonimisë, si dhe renditjes së fjalëve në një fjali që shpesh nuk përputhet në gjuhë të ndryshme. Në kërkim e përdorëm metodën përshkruese, të ndjekur nga një metodë e analizës kontrastive, në të cilën krahasohet përkthimi i autorit me përkthimin me makinë të cilin e morëm. Rezultatet e kërkimit janë paraqitur në mënyrë përshkruese.

5. Rezultatet e hulumtimit

1) Gabimet gramatikore

Nën gabimet gramatikore i konsiderojmë të gjitha ato forma që përkthehen në kohën e gabuar të foljes, pastaj emrat që nuk përkthehen në gjininë dhe numrin e saktë, mbiemrat që nuk përkthehen në shkallën e saktë të krahasimit etj. Sa i përket përkthimit të foljeve, gabimet kryesisht paraqiten në përkthimin e më se të kryerës nga shqipja në serbisht, të cilën Google Translate e përktheu në kohën e kryer, ose në përkthimin e foljeve në kohën e pakryer që do të duhej të përkthehen si folje imperfektive në kuptimin e aspektit, kurse Google Translate i përktheu si folje me kuptim aspektor perfektiv.

Edhe pse më se e kryera nuk përdoret gjerësisht sot në të folurin e përditshëm të serbishtes, në disa shembuj autori ka vendosur ta mbajë këtë formë, gjë që e thekson rëndësinë e ruajtjes së autenticitetit të veprës origjinale. Përkthimi i emrave dhe mbiemrave në kuptimin gramatikor në këta shembuj nuk tregoi shmangie.

2) Gabimet leksikore

Gabime leksikore nuk pati aq sa pritej. Ato u referohen atyre fjalëve në tekst që mund të kenë kuptime të shumëfishta dhe përkthyesi i makinës i ka përkthyer në atë mënyrë që të mos e japin kuptimin e duhur në fjalinë e përkthyer në serbisht. Për shembull, emrin *ankth* autori i përkthimit e përktheu *teskoba*, kurse në përkthimin e Google Translate *anksioznost*.

3) Gabimet stilistike

Gabimet stilistike janë të ngjashme me gabimet e fjalorit, por ato u referohen disa fjalëve apo edhe një fjalie të tërë, gjë që e kufizon kuptimin dhe kuptueshmërinë gjatë leximit. Për shembull, folja *fërkohem* përkthehet si *trljajući se* edhe pse bëhet fjalë për një pallto dhe një përkthim më i mirë do të ishte *zapinjući*, dhe në të njëjtën fjali emri *palat* në serbisht përkthehet si *bokovi*, megjithëse ende flet për pallton dhe do të duhej të flitet për *postavi kaputa* (astari i palltos). Kështu, shprehja *mbajti vesh* Google përkthen si *slušati* kurse autori *načuliti uši*, kuptimi i së cilës është më specifik dhe më kuptimplotë për shkak të kontekstit, ose shprehja *dera gjysmë e hapur* që përkthehet fjalëpërfjalshëm si *poluotvorena vrata*, edhe pse në serbisht përdoret mbiemri *odškrinut*. Në rastin e gabimeve stilistike, roli i përkthyesve profesionalë është veçanërisht i rëndësishëm për t'i njohur nuancat e lartpërmendura dhe për të gjetur alternativa adekuate, duke krijuar kështu një përkthim cilësor.

4) Termi i gabuar

Surpriza më e madhe ndodhi kur në një gabim të cilin e quajtëm "term i gabuar", i cili ishte rezultat i mosdallimit të një lloji të caktuar të fjalës nga përkthyesi i makinës ose përdorimi i një fjale me një kuptim krejtësisht të ndryshëm. Ky gabim ka ndodhur në një masë të konsiderueshme, gjë që ndikon në cilësinë e përkthimit dhe vendimin që ta përdorë përkthyesi me makinë për përkthimin nga shqipja në serbisht. Për shembull, në fillim të kapitullit, mbiemri *hijerënda* me kuptim *impozantan, masivan* përkthehet si *elegantne* ose për mbiemrin *i hirtë* Google Translate ofron përkthim të gabuar *dražesan* në vend të shprehjeve *sumoran, tmuran* (duhet theksuar se në këtë shembull përkthimi e ka zbatuar formën gramatikore për shkallën krahasore të mbiemrave) ose emër *qesëndi* që përkthehet si *tuga*, në vend të fjalës *poruga, rujanje, podsmeh*. Mosdallimi i fjalëve në përkthimin me makinë do të krijonte një konfuzion të madh gjatë leximit të tekstit letrar dhe në disa pjesë përkthimi do të humbiste plotësisht kuptimin e tij.

5) Përkthimi i fjalëpërfjalshëm

Një nga problemet kryesore me përkthimin me makinë kur flasim për përkthimin e teksteve letrare është se në shumicën e rasteve ne marrim e përkthimin e fjalëpërfjalshëm, i cili shpesh nuk e ka mesazhin dhe kuptimin e njëjtë si vepra në gjuhën origjinale. Gjithashtu, përkthimi i fjalëpërfjalshëm nuk mund të përcjellë emocionin që ka një vepër letrare dhe në mënyrë artificiale përcjell stilin që ka autori kur shkruan në gjuhën e vet origjinale. Siç pritej, ky lloj gabimi ishte i shpeshtë, si në shembujt *ai s'kishte punë me ta – on nije imao posla s njima* në vend të shprehjes *njega se to nije ticalo* ose *mbi lëvizjen e rrugës – iznad kretanja ulice* në vend të shprehjes *nad uličnom vrevom*, të cilën e zgjodhi autori.

6) Fjalët të cilat mbeten të papërkthyer

Këtu i kemi përfshirë fjalët të cilat përkthyesi me makinë i la mënjanë nga përpunimi i tekstit. Në përkthimin nga shqipja në serbisht, fjalë të tilla janë emrat e përveçëm, të cilët kanë mbetur në të njëjtën formë ose janë transkriptuar gabimisht në gjuhën serbe. Fjalët që përkthyesi i makinës i ka lënë në formën e vet origjinale mund të shkaktojë mungesë informacioni bazë për tekstin, pasi janë kryesisht emra të përveçëm, gjë që e prish kuptimin në përkthim.

SHEMBULLI NGA TEKSTI ORIGJINAL	PËRKTHIMI I AUTORIT	GOOGLE TRANSLATE	LLOJI I GABIMIT
Ndërtesat hijerënda	Masivne visoke zgrade	Elegantne zgrade	Mosdallimi i mbiemrave; Term i gabuar
Mbi lëvizjen e rrugës	Nad uličnom vrevom	Iznad kretanja ulice	Përkthimi i fjalëpërfjalshëm; Gabim leksikor
E bënin edhe më të hirtë fillimin e ditës	Početak dana činili su tmurnijim	Učinile su početak dana još dražesnijim	Mosdallimi i foljeve; Mosdallimi i mbiemrave; Gabim gramatikor; Term i gabuar
Por aty për aty qetësoi veten	Ali se odmah umirio	Ali se odmah uverio	Mosdallimi i foljeve; Term i gabuar

Ai s'kishte punë me ta	Njega se to nije ticalo	On nema posla s njima	Përkthimi i fjalëpërfjalshëm; Gabim stilistik
Mark-Alemi ndjeu ankthin	Teskoba	Anksioznost	Përkthimi i fjalëpërfjalshëm; Gabim leksikor
Me sy të palëvizshëm	Ukočenog pogleda	Uprtim očima	Gabim stilistik
Ai vështronte ca frone të gjata	On je ugledao nekoliko dugačkih klupa	Zurio je u neke dugačke prestole	Përkthimi i fjalëpërfjalshëm; Gabim stilistik
Mbajti vesh	Načulio uši	Slušao	Gabim stilistik
Dera kishte mbetur gjysmë e hapur	Vrata su bila ostala odškrinuta	Vrata su ostala poluotvorena	Mosdallimi i kohës së foljes; Përkthimi i fjalëpërfjalshëm; Gabim gramatikor; Gabim stilistik
Një shkëndije qesëndie	Neku iskru poruge	Iskru tuge	Dështimi për të njohur një emër; Term i gabuar
Njeriu i shkurtër	Čovečuljak	Niski čovek	Përkthimi i fjalëpërfjalshëm; Gabim stilistik
Duke u fërkuar në mënyrë armiqësore me palat e palltos	Zapinjući o postavu kaputa koja se bila pretvorila u dušmanina	Trljajući se neprijateljski o bokove kaputa	Përkthimi i fjalëpërfjalshëm; Gabim stilistik
E shtoi zymtinë	Pojačao sumorno raspoloženje	Doprinosi sumračenju	Përkthimi i fjalëpërfjalshëm; Gabim leksikor
Vetëtimthi mendoi se mos e kishte dëgjuar gabim	On pomisli da ih je možda pogrešno čuo	A munja je umislila da nije pogrešno čuo	Mosdallimi i fjalëve; Term i gabuar
Kishte humbur	Bio izgubio	Je izgubio	Mosdallimi i kohës së foljes; Gabim gramatikor
Kishte lexuar	Bio pročitao	Je pročitao	Mosdallimi i kohës së foljes; Gabim gramatikor
Salla e Qigrave	Rešetom	Dvorana čikade	Mosdallimi i togfjalëshit; Term i gabuar
Punë e trashë grahësish	Prosto dirinčenje	Glup ženski posao	Mosdallimi i shprehjeve; Term i gabuar
Zhurma e hapave	Topot koraka	Zvuk koraka	Sinonimia
Gjëmimi i hapave	Topot	Tutnjava koraka	
Grumbullim	Prijemno odeljenje	Grumbullimu	Ka mbetur pa u përkthyer

Në Kopisteri	U Kopirnici	U Kopisteri	Ka mbetur pa u përkthyer
Nga Qyprillinjtë	Iz porodice Ćurpilija	Sa Kipra	Mosdallimi i emrit; Term i gabuar
Nga familja e Qyprillinjve?	Iz porodice Ćurpilija	Iz porodice Ciprill?	Ka mbetur pa u përkthyer
Nga Qyprillinjtë	Od Ćuprilija	Iz Kiprilinja	Ka mbetur pa u përkthyer
Puna e bashëndrrës	Stvar sa velesnom	Posao svekrve	Mosdallimi i emrit; Term i gabuar

6. Përfundim

Në bazë të analizës së bërë, u vërtetua hipoteza fillestare se përkthimi me makinë nga shqipja në serbisht nuk është ende mjaft i përmirësuar, në mënyrë që përkthyesit profesionalë të mund ta përdorin pa korrigjime. Pyetja që lind është – a do t'i zëvendësojë përkthimi me makinë njerëzit si përkthyes? Përgjigjja është ende e paqartë, si dhe nëse ky lloj përkthimi do të përmirësohet me kalimin e kohës kur të rritet korpusi i materialeve në kujtesën e përkthyesve të makinës. Është e sigurt se përmirësimi i inteligjencës artificiale, si dhe përmirësimi i programeve kompjuterike, do t'i përmirësojë edhe veglat e internetit që përdoren për përkthim. Përkthimi pa faktor njerëzor mund të jetë i mirë nëse plotësohen disa parakushte ose si gjë rasti.

Është shumë e rëndësishme të rritet vetëdija për gabimet që ndodhin gjatë përdorimit të internetit për qëllime përkthimi të përdoruesit, në mënyrë që të kufizohet përdorimi i tij dhe të kontrollohen përkthimet e këtilla dhe në këtë mënyrë të kufizohet përhapja e përkthimeve të këqija. Softueri nuk mund të kuptojë gjithçka që kërkon kuptim më të thellë, hulumtim dhe gjetje të gabimeve në një tekst, për këtë arsye nevojitet pjesëmarrja e njerëzve që do ta përpunonin më tej përkthimin. Ai nuk mund t'i dallojë nuancat në kuptimin e një numri të caktuar të fjalëve, nuk mund të tregoj se sa është krijuar dhe t'i shfaqë kuptimet e fshehura, por edhe ironinë dhe ndjenjat, të cilat mund të ndikojnë në mënyrë drastike në kuptimin e thelbit të tekstit.

Dallimi kryesor midis përkthimit me makinë dhe përkthimit të autorit është se një person përshtatet në mënyrë të pandërgjegjshme me të gjitha rrethanat – ai e ka aftësinë që ta përshtatë një tekst të paqartë, të pathënë dhe të dykuptimshëm një mënyrë adekuate me qëllimin e duhur. Ai mund t'i njohë gabimet dhe mungesën e fjalëve dhe të kategorive të caktuara dhe të vendosë më tej se si t'i trajtojë ato, gjë që flet për zgjedhjet e vazhdueshme që duhet t'i bëjë përkthyesi – p.sh. që të vendosë për një sinonim të veçantë që do t'i përshtatej më mirë kuptimit të tekstit, gjë që një përkthyes i makinës nuk mundet. Nga ana tjetër, makinat shpesh nuk i marrin vendimet e duhura dhe përkthimi i tyre nuk mund të konsiderohet si gjuhë natyrale. Përkthimi me makinë është arritur në një nivel të caktuar falë njohurive dhe përkushtimit të programuesve që kanë punuar për përmirësimin e tij dhe sigurisht që ka një potencial të madh.

Mund të shërbejë si bazënisje, të cilën më tutje do ta përpunojnë njerëzit dhe avantazhi më i madh i tij është se, për shkak të shpejtësisë së tij, e kursen kohën që duhet për të bërë një përkthim. Prandaj, përkthyesit e makinës mund të na ndihmojnë shumë nëse i përdorim në një masë të nevojshme, por me shumë kujdes në drejtim të njohjes dhe të korrigjimit të gabimeve që ai bën. Gjithashtu, në çiftet e tjera gjuhësore dhe në llojet e tjera të përkthimit, këta përkthyes me siguri mund të tregojnë efektshmëri më të madhe ose më të vogël.

Referencat

- [1]. Јеротијевић, Д. (2012). Превод као психолингвистички процес – пример: превод Орвеловог романа 1984. *Наслеђе*, 21, 165–181.
- [2]. Рајић, Ј. (2008). Превођење у светлу прагмалингвистичких проучавања – комуникативна функција превођења. *Наслеђе*, 5(11), 47–53.
- [3]. Alili, I. (2020). Sfidat e përkthimit sot. Përkthimi dhe ndikimi i tij në shkencë dhe në shoqëri. *Filologjia*, vol. 8, no. 13-14, 38–43.
- [4]. Arnold, D. J. (2003). Why translation is difficult for computers. U: Somers, H. (ured.), *Computers and Translation: A translator's guide* (str. 119–142). Amsterdam: John Benjamins.
- [5]. Forcada, M. (2010). Machine Translation Today. U: Y. Gambier (ured.) (2010). *Handbook of Translation Studies* (215–223). Amsterdam/Philadelphia: John Benjamins Publishin Company.
- [6]. Hansen, G. (2010). Translation 'errors' U: Y. Gambier (ured.) (2010). *Handbook of Translation Studies* (385–388). Amsterdam/Philadelphia: John Benjamins Publishing Company.
- [7]. John Hutchins, W. & Somers L., H. (1992). *An Introduction to Machine Translation*. London: Academic Press.
- [8]. Kadare, I. (2011). *Pallati i Ēndrrave*. Tiranë: Onufri.
- [9]. Kadare, I. (2016). *Palata snova*. (Š. Malići, prev.). Beograd: Samizdat B92.
- [10]. Levy, J. (2011). *The Art of Translation*. Amsterdam/Philadelphia: John Benjamins Publishing Company.
- [11]. Murtezi-Ajdini, Sh., Saliu, D. & Saliu, B. (2022). Language Errors in Translated Texts of Primary Education. *Albanologjia*, vol. 9, no. 17-18, 242–249.
- [12]. Newmark, P. (1988). *A Textbook of Translation*. New York: Prentice Hall.
- [13]. Saliu, Z. (2023). Përkthimi i teksteve me ndihmën e “Google Translate”. *Albanologjia*, vol. 10, no. 19-20, 552–556.
- [14]. Xhaferi, A. (2023). Gjuha dhe përkthimi – Ruajtja e elementit thelbësor. *Filologjia*, 11(20-21), 7–10.